

Raport i Konsultimit për projektligjin "Për Strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë"

1. Titulli i draft aktit

Projektligji "Për Strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë".

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Për këtë projektligj janë zhvilluar edhe konsultime në fazën paraprake përmes ngritjes së Grupit Ndërinstitucional të Punës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.24 datë 9.02.2021, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore", i cili kishte si objekt veprimtarie finalizimit e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore.

Takimet e grupeve të punës dhe pikave të kontaktit të institucioneve, për konsultimin e projektligjit "Për Strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë" janë zhvilluar gjatë periudhës nëntor 2021 (2 takime në total).

Janë realizuar edhe takime konsultuese në nivel ekspertësh në çdo Këshill Baseni Lumor, përkatësisht sipas rendit në vijim:

1. Takim konsultues në KBU Drin - Bunë, datë 22 qershor 2022;
2. Takim konsultues në KBU Mat date 23 qershor 2022;
3. Takim konsultues në KBU Erzen date 24 qershor 2022;
4. Takim konsultues në KBU Ishëm datë 27 qershor 2022;
5. Takim konsultues në KBU Seman date 30 qershor 2022;
6. Takim konsultues në KBU Shkumbin date 4 korrik 2022;
7. Takim konsultues në KBU Vjosë date 6 korrik 2022.

Konsultimi i Projektligjit në RNJEK pati një kohëzgjatje prej 20 ditësh nga data e publikimit specifikisht filloi në datë 06.06.2022 dhe u mbyll më datë 29.07.2022.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprahe nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin "Për Strategjinë detare të Republikës së Shqipërisë" ishin katër:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK;
2. Takime konsultuese në çdo KBU;
3. Email.
4. Konsultimit përmes publikimit në faqen zyrtare të AMBU-së.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

Anëtarët e grupit të ndërinstitucional punës në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr.24 datë 9.02.2021:

- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.
- Ekspertët e projektit EUSIWM, të cilët kanë përgatitur draftet fillestare të projektligjeve.

Gjithashtu gjatë fazës së organizimit të takimeve në nivel Këshilli Baseni Ujor, morën pjesë anëtarët e këtyre këshillave (përfaqësues të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe grupe interesi) si dhe u ftuan përfaqësues të universiteteve dhe organizata jo fitimprurëse objekti i veprimtarisë së të cilave lidhet me burimet ujore.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi

Lidhur me rezultatet e konsultimeve, përsa i përket RENJK nuk ka pasur komente lidhur me projektaktin e propozuar.

Ndërsa në takimet e zhvilluara në nivel KBU-je, komentet e adresuara kanë qenë të lidhura kryesisht me aspektet e problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit. Në tërësi përfaqësojnë ndaj ligjit të ri ka qenë pozitive.